### DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS<sup>4</sup>

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

---

<sup>4</sup> Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;
- g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- Sipas shtojcës 12, pika 1.

### 2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve (2017-2018-2019), të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve.

2. Vërtetim të lëshuar nga organet tatimore, mbi xhiron për 3 vite vitet e fundit financiare (2017,2018,2019). Xhiro mesatare e tre viteve të fundit nuk duhet të jetë më e vogël se 50 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

3. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezultojnë se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

4. Vërtetim për pagimin e taksave vendore **2018-2019-2020** sipas vendit ku ka ushtruar aktivitetet në keto **3 vite**.

### 1. Per kapacitetin teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.



përmbyjë kategoritë e mëposhtme sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes:

**NP.1- C**, Punime gërmimi në tokë

**NP.2- B**, Ndërtime civile dhe industrial

**NP.5- A**, Punime nëntokesore, ura e vepra arti

**NP.7- E**, Ndërtime ujësjetllësi

**N.P 11-B** Ndërtime për N/stac., kab. e transform. linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

**NP.12- D** Punime të inxhinjeris së mjedisit

**NS. 1- B** Punime për prishjen e ndërtimeve

**N.S 6- A** Sinjalistike rrugore jo ndricuese

**N.S 7- A** Barrier dhe mbrojtje rrugore

**NS.9- B**, Punime strukturore speciale

**NS.10-B**, Shtresa dhe struktura special

**NS. 16-B**, Ndërtim i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

**NS.18- B**, Punime topogjeodezike

#### **4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO:**

- Çertifikate për Sistemin e manaxhimit të cilësisë (ISO 9001:2015) ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Çertifikate për Sistemin e manaxhimit të mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Çertifikate për Sistemin e manaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (OHSAS 45001:2018) ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Çertifikate për sistemin e integruar BS PAS 99:2012 ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Çertifikate për sigurinë në trafikun rrugor BS ISO 39001:2012 ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Çertifikate konformiteti për sistemin e menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore SA 8000: 2014 ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Çertifikate konformiteti për shqyrtimin e Standarteve Europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit. DS CEN – TR 15128:2005 ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Çertifikate konformiteti për sistemin për veshjen kanalaëve standarti BS EN 13331:1-2002
- Çertifikate konformiteti për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim EN –ISO 3834-2:2006 ose ekujvalente (e vlefsheme).
- Sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë kullimet dhe kanalizimet nëntokesore dhe mbitokesore nën presion ISO 1452-1:2009 (e vlefshme)
- Çertifikate konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001:2013
- Çertifikate konformiteti për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001:2011 (e vlefshme)

Te gjitha çertifikata e mesiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë perkatesisht Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes). Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme.

5. **Per të provuar se ka përvorjen e duhur, Operatori duhet të deshmtojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 110 (Njëqind e dhjetë) personave** duke përfshirë edhe stafin teknik menaxherial, për periudhën **Janar 2020 – Nëntor 2020** të deshmuar me;
  - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e mesipërme .
  - b. Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimit që kërkohet nga legjislati në fuqi për secilin nga muajt në periudhën e mesipërme.
  
6. **Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të Projektit në objekt** i cili duhet të jetë inxhinier Ndërtimi, i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, i cili të kenë eksperiencë pune jo më pak se 15 vjet. Drejtuesi Teknik i Projektit të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
  - Librezë pune (përkatesë)
  - Kontratë pune e vlefshme (përkatesë)
  - Diplomë
  - Cv.
  
7. **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si regjistruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Nëntor 2020, minimalisht:**
  - a) Inxhinier Ndërtimi 2 me eksperiencë pune min. 10 vjet
  - b) Inxhinier mjedisi me VNM 1 me eksperiencë pune min. 10 vjet
  - c) Inxhinier Ndërtimi 1 profili Infrastruktura
  - d) Urbanist pajisur me Licence Individuale në plan të detajuar vendore
  - e) Teknik ndërtimi 3 punonjës
  - f) Agronom
  - g) Shoqëria duhet të ketë të punësuar dy persona nga personeli teknik (të jenë Drejtues Teknik në Licence) të pajisur me certificate për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë
  - h) Shoqëria duhet të ketë të punësuar dy persona nga personeli teknik (Njeri të jetë Drejtues Teknik në Licence) të pajisur me certificate për ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave.
  - i) Shoqëria duhet të ketë të punësuar një person nga personeli teknik (të jetë Drejtues Teknik në Licence) të pajisur me certificate për sigurimin dhe kontrollin e cilesisë sipas ISO 9001:2015.
  - j) Shoqëria duhet të ketë të punësuar një ekspert zjarrefikes
  - k) Shoqëria duhet të ketë të punësuar një ekspert mjedisi të pajisur me licence të kodit III.2.A (1+2)
  - l) Puntori e specializuar me makineri, manovratore 8 punonjës të pajisur me deshmë nga D.P.Sh.T.T.Rr.

- m) Puntori e specializuar në drejtim mjete të rënde 8 punonjës të pajisur me dëshmi nga D.P.Sh.T.T.Rr.
- n) Inxhinier Elektronik në Licencën e Shoqërisë
- o) Teknik Elektronik

Si dhe,

Punetori e specializuar në ndërtim, stafi i Shoqërisë duhet të ketë 18 persona si mëposhtë:

- a) Dëshmi kualifikimi profesional+IQT Hidraulik 4 punonjës
- b) Dëshmi kualifikimi profesional+IQT Mekanik 3 punonjës
- c) Dëshmi kualifikimi profesional+IQT Elektricitet 5 punonjës
- d) Dëshmi kualifikimi profesional+IQT Karpentier 4 punonjës
- e) Dëshmi kualifikimi profesional+IQT Pllakashtrues 1 punonjës
- f) Dëshmi kualifikimi profesional+IQT Hekurkthyes 2 punonjës
- g) Saldues dhe montues tuba sipas standardit UNI EN 13067:2013 me dëshmi kualifikimi 3 punonjës
- h) Lemues graniti me dëshmi kualifikimi+IQT 1 punonjës

Per të vërtetuar punësimin e të gjithë stafit teknik dhe punëtorisë së specializuar/thjeshtë si mesipër, Shoqëria duhet të paraqesë listëpagesat që vërtetojnë se punonjësit e mesipër janë të deklaruar sipas kodit përkatës të sigurimeve për gjatë gjithë periudhës së së përcaktuar në pikën 7, kontratat e punës, diplomat/dëshmi kualifikimi/certifikata/licensa që vërtetojnë kualifikimin e tyre profesional dhe IQT.

**8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se disponon stafin mbështetës si mëposhtë:**

- a) Shoqëria duhet të ketë të punësuar një person nga personeli teknik të certifikuar për trajtimin e ujërave.
- b) Shoqëria duhet të ketë të punësuar një person nga personeli teknik të certifikuar për testimin e presionit në tubacionet e ujit sipas EN 805.
- c) Shoqëria duhet të ketë të punësuar një person nga personeli teknik të certifikuar nga FIDIC për menaxhimin e kontratave.

Per stafin mbështetës Shoqëria duhet të paraqesë kontratat e punës, diplomat/dëshmi kualifikimi/certifikata/licensa që vërtetojnë kualifikimin e tyre profesional dhe të figurojnë në listëpagesa minimalisht muajin e fundit që I përket datës së zhvillimit të tenderit.

- 9. **Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licence III.2.B** (grumbullim, transportim, përpunim dhera, inerte) si dhe i pajisur me Licence III.2.B (Grumbullim, magazinim dhe transport i mbetjeve jo të rrezikshme)
- 10. **Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licence III.2.A (1+2)** (Vlerësimi I Ndikimit në Mjedis)
- 11. **Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licence III.1.A Tipi C** (Magazinim dhe /ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë -llumin nga ujërat e ndotura urbane -llumin e cisternave septike -mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura -mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza)
- 12. **Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licence I.2.A** (Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave të çdo lloji. Hartimi i akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rena)
- 13. **Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm.** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej



operatorëve që plotëson kriteret e VKM 742 date 06.11.2013., I ndryshuar .duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. (marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës)

14. **Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojnë për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi staf shtesë me kontratë të rregullt pune për objektin në fjalë, 1 (një) ekspert të pajisur me “Liçencë zbatimi për veprimtari Arkeologjike” me qëllim që të monitorohen punimet për të mos patur pasoja të mundshme në Arkeologji nga implementimi i projektit. Duke ditur që në zonën ku do inplemontohet projekti dhe në ato përreth ka pasur gjetje të materialeve Arkeologjike.**
15. **Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.** Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1.	Automjete vetëshkarkues me tonazh mbi 25 ton	Copë	4
2.	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	Copë	2
3.	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtes minimum 10 (dhjete) ton dhe maksimumi 15 (pesëmbëdhjete) ton	Copë	2
4.	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	Copë	2
5.	Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	Copë	2
6.	Automjet me kosh per punime ne lartesi	Copë	1
7.	Betoniere	Copë	3
8.	Depozita uji	Copë	3
9.	Autvinc 7-10 ton	Copë	1
10.	Gjenerator jo me pak se 200 kva	Copë	1
11.	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 18 ton)	Copë	2
12.	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 12 ton)	Copë	2
13.	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton)	Copë	1
14.	Rrul asfalti me gome - gome (Kapaciteti jo me pak se 4 ton)	Copë	1
15.	Kompresor	Copë	2
16.	Autobot uji me sprucator	Copë	1
17.	Freze asfalti	Copë	1
18.	Autobetoniere	Copë	4
19.	Fadrome me kove perpara dhe mbrapa	Copë	2

Ndërtim i Rrjetit të Ujësllësit në zonën Fushë Kamëz

20	Pompe betoni	Copë	2
21	Pajisje për testimin e presionit	Copë	1
22	Pompe presioni për testim hidraulik	Copë	1
23	Instrument i kombinuar për PH, Ocuqen, Temperaturën, Trazimin dhe mbetjet e klorit	Copë	1
24	Pajisje e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes/prurjes ( Pajisja digitale )	Copë	3
25	Eskavator me goma	Copë	2
26	Asfaltoshtruese	Copë	2
27	Impiant automatik betoni të pajisur me QKL kodit II 1.A	Copë	1
28	Eskavator me zinxhire	Copë	3
29	Eskavator me zinxhire me cekic pneumatic	Copë	1
30	Minifadrome	Copë	1
31	Bobcat	Copë	1
32	Dumper	Copë	2
33	Minieskavator	Copë	4
34	Set semaforesh	Copë	2
35	Gazogjen	Copë	1
36	Nyje inertesh të pajisur me leje mjedisore III.1.B dhe IV.1 B 2	Copë	1
37	Fabrike asfalti pajisur me leje mjedisore III.1.B	Copë	1
38	Zmerilatrice	Copë	1
40	Makineri për shkulje pemesh	Copë	1
41	Trancher me vakum me punime specifike	Copë	1
42	Trancher për hapje kanali 20 ton	Copë	1
43	Makine teknologjike për pastrim puseta të ujësllës kanalizime të zgarave të shiut vetëshkarkuese me kazan të mbyllur dhe transport materialeve mbetjesh të ndryshme	Copë	1
44	Sonde për zhblokim dhe pastrim të kanalizimeve , të shiut dhe tubacioneve të ndryshme	Copë	1
45	Autobot për zhblokim kanalizimesh pajisur me pompe presioni dhe pompe vakumi vetëshkarkuese të pajisur edhe me depozite për transport të ujit të pastër dhe mbetjeve të tjera	Copë	1
46	Batipal për ngjeshjen e kanaleve	Copë	1
47	Sistem wellpoint	Copë	1
48	Aparat për ngjitjen e tubave koke me koke ndër të cilët njëri të jetë CNC	Copë	3
49	Makine shpues horizontale për tejkalimin e rrugeve	Copë	1

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje si dhe në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme targa e mjetit.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 10 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 100 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 15 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 copë
- Rripa sigurimi minimumi 5 cope
- Prozhektor ndricimi naten minimumi 5 cope
- Fikese zjarri minimumi 5 cope

Pajisjet e mesiperme të provohen me dorezimin e faturave të blerjes, akti cdoganimi ose kontratave të marra me qera të pajisjeve.

**16. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontrate furnizimi të zyrtarizuar me prodhuesin/distributorin e tubave dhe rakorderive që do të vendosen në objekt, i shoqëruar me çertifikatë ISO 9001:2008 të prodhuesit të mallit, Autorizimin nga prodhuesi/distributori dhe katalogjet teknike të mallit të kerkuar. Në rastet e paraqitjes së autorizimit nga distributori, duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të mallit.**

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikaten e mesiperme duhet ta paraqesë anëtar i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit).

Operatori ekonomik pjesëmarrës në tendër së bashku me grafikun e punimeve, preventivin duhet të dorëzojë edhe analizat teknike për zërat kryesor të preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007, umenteve zyrtare të huaja". (Konventa e Hagës 5 TETOR 1961)

Do të organizohet një vizitë në kantier **10 dite para dates së zhvillimit të tenderit** në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Kjo për shkak edhe të vështirësive të zbatimit në terren për arsye të kalimit të linjave në shumë banesa private. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Pas kësaj vizite do të mbahet një proces-verbal dhe të gjithë Operatorët Ekonomikë të pranishëm do të pajisen me një vertetim i cili duhet të paraqitet në fazën e konkurimit. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata.

Dokumentet e siguruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara me vulë apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dok

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar "Apostile". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës.

Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në përputhje dhe përputhje me punët e marra për sipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala "periudhë" nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## **Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

### **PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 16

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e



*shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra në bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes të dhena në projekt të cilat janë orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa në dorë.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes të dhena në projekt shoqëruar me cmimet për njësi të pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime në matje.
- 2.3 “Afati i realizimit të punimeve” do të thotë data që Punët duhet të përfundojnë siç është shprehur në Grafikonin për realizimin Punimeve, e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndërtimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndërtimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtuës projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartzimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtë ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjyqimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

#### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

#### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

#### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
